



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 655/6 Prot.

Tiranë, më 17.11.2021

**V E N D I M**

Nr.145, Datë 17.11.2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË  
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN INSPEKTORI I  
LARTË I DREJTËSISË DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Inspektori i Lartë i Drejtësisë,

**VËREJ SE:**

Me Vendimin nr.64, datë 3.6.2021, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Inspektori i Lartë i Drejtësisë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në institucionin Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si institucion i pavarur, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, “fusha e veprimit të tij

*shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”.*

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë aplikimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 655/1 prot., datë 3.6.2021, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili, me shkresën nr. 655/3 prot., datë 3.6.2021, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i është njoftuar institucionit.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nga ku ka rezultuar se, në institucionin e mbikëqyrur, që nga periudha e fillimit të funksionimit të tij, Shkurt 2020 deri Maj 2021, janë plotësuar me konkurrim 41 pozicione pune, nga të cilat, 17 pozicione pune të kategorisë ekzekutive janë plotësuar me lëvizje paralele dhe me pranim në shërbimin civil; 23 pozicione pune të kategorisë së ulët e të mesme drejtuese janë plotësuar me lëvizje paralele dhe me ngritje në detyrë e pranim nga jashtë shërbimit civil; ndërsa, 1 pozicion pune i kategorisë së lartë drejtuese, është plotësuar me ngritje në detyrë.

Në të gjitha rastet, ka rezultuar se, procedurat e konkurrimit janë zhvilluar në përputhje me parimet dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe duke respektuar procedurën e plotësimit të vendeve të lira që përcaktojnë aktet nënligjore që kanë dalë në bazë e në zbatim të ligjit.

Projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 655/4 prot., datë 26.10.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në lidhje me mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil”*, duke i lënë një afat 10 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr.2607/3 prot., datë 4.11.2021, *“Mbi dërgim projektraporti”*, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me konstatimet e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, në institucionin Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes, në kushtet kur nuk janë konstatuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil.
2. Për këtë vendim të njoftohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**